

Prot. nr. 1409
dt. 17.06.2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL SHQIPTAR

BULETIN INFORMUES

ACAA-DAS-IB-No.001

Lëshimi: 01, Rishikimi 01

Datë: 17.06.2026

Pranuar nga:

Maksim Et'hemaj

Drejtor Ekzekutiv i Autoritetit të Aviacionit Civil



0.1 Regjistri i Rishikimeve

Nr. Lëshimit	Nr. Rishikimit	Data	Rishikuar nga:	Natyra e Ndryshimit
01	00	26.05.2026	DAS	Lëshim fillestar
01	01	17.06.2026	DAS	EASA SIB No.2026-06

0.2 Tabela e Rishikimit

Faqe #	Nr. Lëshimit	Nr. Rishikimit	Data	Rishikuar nga:

EASA Nr. SIB: 2026-06

Data e lëshimit: 12 Qershor 2026

Subjekti: Sëmundja Ebola (EVD) – Rekomandime Operacionale

Ky Buletin Informues (BI) zëvendëson EASA SIB 2014-28R1 të datës 26 Nëntor 2014, i cili shfuqizohet.

ZBATUESHMËRIA

Ky dokument u drejtohet:

- Autoriteteve Kombëtare Kompetente (NCA);
- Operatorëve ajror;
- Operatorëve të aerodromeve.

PËRSHKRIMI

Ky BI është lëshuar për të adresuar mjedisin e sigurisë në operim lidhur me shpërthimin e sëmundjes Ebola të shkaktuar nga virusi Bundibugyo (BVD).

Më 16 Maj 2026, Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSh) deklaroi se shpërthimi i sëmundjes Ebola i shkaktuar nga virusi Bundibugyo përbën një Emergjencë të Shëndetit Publik me Rëndësi Ndërkombëtare.

Sipas evidencave aktuale të ECDC, OBSh, CAPSCA dhe Komitetit të Sigurisë Shëndetësore, rreziku i përgjithshëm i transmetimit të BVD gjatë transportit ajror komercial mbetet akoma shumë i ulët për pasagjerët, ekuipazhet dhe personelin tjetër të aviacionit.

Viruset Ebola janë shumë ngjitëse, por transmetohen vetëm nëpërmjet kontaktit të drejtpërdrejtë me gjakun ose lëngje të tjera trupore (si pështymë, urinë ose të vjella) të personave të infektuar, të gjallë ose të vdekur, ose përmes sipërfaqeve dhe materialeve të kontaminuara nga këto lëngje.

Transmetimi nuk ndodh përmes ajrit ose kontaktit të zakonshëm. Aktualisht nuk ka vaksina të licencuara apo trajtime specifike për llojin Bundibugyo të virusit.

RASTET E DYSHUARA

Duhet të dyshohet për BVD kur një udhëtar ka qenë në një vend të prekur gjatë 2–21 ditëve të mëparshme dhe paraqitet me temperaturë të lartë (mbi 38.6°C) ose ethe dhe/ose shfaq shenja të tilla si:

- gjendje e dukshme sëmundjeje;
- diarre e vazhdueshme;
- të vjella të vazhdueshme;
- skuqje të lëkurës;
- mavijosje të pashpjegueshme;
- konfuzion.

UDHËTIMET DHE TREGTIA

OBSH, IATA dhe HSC janë kundër kufizimeve të përgjithshme të udhëtimit ose tregtisë me Republikën Demokratike të Kongos dhe Ugandën.

Pezullimi i fluturimeve ose refuzimi i hyrjes së udhëtarëve nuk rekomandohet, pasi do të ndërpriste rrjetet jetike humanitare të furnizimit.

Kontrollet e hyrjes në aeroportet e BE/EEA konsiderohen të kushtueshme dhe joefektive për parandalimin e importimit të rasteve të infektuara.

REKOMANDIME PËR OPERATORËT AJRORË

Menaxhimi i Rrezikut:

- Duhet të përditësohen proceset e identifikimit të rreziqeve, vlerësimit dhe masave zbutëse.

Procedurat:

- Duhet të ndiqen procedurat e manualit operacional për trajtimin e sëmundjeve infektive të dyshuara.

Kontrolli i Infeksionit:

- Ekuipazhi duhet të shmangë kontaktin me gjakun dhe lëngjet trupore.

Trajnimi:

- Programet e trajnimit duhet të përfshijnë identifikimin e rasteve të dyshuara.

- Duhet të theksohet izolimi i menjëhershëm i pasagjerit dhe përdorimi i kompleteve universale të masave paraprake (UPK).

Komplete Universale të Masave Paraprake (UPK):

- Avionët që operojnë drejt ose nga zonat e prekura duhet të pajisen me një ose më shumë UPK.

Mbrojtja e Bazuar në Vlerësimin e Rrezikut:

Përdorimi i kompleteve dhe pajisjeve personale mbrojtëse (PPE) duhet të përcaktohet në funksion të nivelit të rrezikut, me qëllim garantimin e mbrojtjes nga ekspozimi i mundshëm ndaj lëngjeve trupore gjatë menaxhimit të një pasagjeri të sëmurë në avion.

MASA SHITESË PËR PASAGJERËT E DYSHUAR

Nëse dendësia e ulëseve nuk lejon një distancë izolimi prej 2 metrash rreth pasagjerit me temperaturë, ekuipazhi duhet të shpërndajë maska kirurgjikale dhe pajisje mbrojtëse për pasagjerët pranë tij.

Raportimi i Detyrueshëm:

- Çdo rast i dyshuar duhet të raportohet menjëherë.
- Pilotët duhet të njoftojnë kontrollin e trafikut ajror për të siguruar asistencë pas uljes.

Gjurmimi i Kontakteve:

- Operatorët duhet të ruajnë të dhënat e sakta të pasagjerëve.
- Duhet të jenë në gjendje të dorëzojnë listat e pasagjerëve dhe formularët e lokalizimit të pasagjerëve (PLF).

Pastrimi dhe Dezinfektimi:

- Nëse identifikohet një udhëtar simptomatik, avioni duhet të pastrohet dhe dezinfektohet.
- Materialet e ndotura duhet të ruhen në qese të etiketuara "BIOHAZARD".

AEROPORTET

Aeroportet që presin fluturime direkte nga rajonet e prekura duhet:

- të bashkëpunojnë me autoritetet shëndetësore;
- të sigurojnë mbledhjen e formularëve PLF;
- të lehtësojnë sistemet elektronike ePLF.

Pasagjerët duhet të informohen se:

- mund të udhëtojnë normalisht nëse nuk kanë simptoma;
- duhet të monitorojnë shëndetin e tyre;
- nëse shfaqin simptoma duhet të kontaktojnë menjëherë autoritetet shëndetësore, të shmangin udhëtimet e mëtejshme dhe të izoloohen.

AUTORITETET KOMBËTARE KOMPETENTE

Autoritetet duhet të bashkëpunojnë me institucionet kombëtare të shëndetit publik dhe të sigurojnë zbatimin e këtyre rekomandimeve.

GJURMIMI I KONTAKTEVE PAS KONFIRMIMIT

Në rast konfirmimi laboratorik, gjurmimi kufizohet te:

- a) pasagjerët të ulur një vend përpara, pas ose anash rastit;
- b) ekuipazhi që ka shërbyer në atë seksion;
- c) personeli i pastrimit të avionëve;

d) çdo person që ka pasur kontakt të drejtpërdrejtë me trupin ose lëngjet trupore të të sëmurit.

FORMULARËT ELEKTRONIKË (ePLF)

Formularët Elektronikë të Lokalizimit të Pasagjerëve (ePLF) janë më të lehtë dhe më të besueshëm për t'u përdorur, ofrojnë ruajtje dhe mbrojtje më të mirë të të dhënave, lehtësojnë operimet e avioneve, duke përfshirë kufizimin e kontakteve të drejtpërdrejta të panevojshme ndërmjet anëtarëve të ekuipazhit dhe pasagjerëve, si dhe zvogëlojnë riskun e ekspozimit për personat që plotësojnë fizikisht formularët PLF.

RIATDHESIMI

Kur është e mundur nga pikëpamja mjekësore, transporti i personave simptomatikë duhet të kryhet me ambulanca ajrore ose ambulanca tokësore të dedikuara.

PËRFUNDIMET

Masat e shëndetit publik duhet të jenë proporcionale me rrezikun real të transmetimit në aviacion. EASA konsideron se rreziku i transmetimit të Ebola-s gjatë udhëtimeve ajrore mbetet shumë i ulët, por rekomandon identifikimin e hershëm, izolimin, raportimin dhe gjurmimin e kontakteve.